



Duke u mbështetur në nenin 17, paragrafi 1, nën pika j) dhe m) të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale, Nr.03/L-040, nenit 17 dhe 18 të Statutit të Komunës së Klinës, si dhe Referencës së dt.30.06.2015, Nr.05-3735 nga Ministri i Shëndetësisë për miratim të Statutit të Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF-AKT unik për të gjitha Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor të Kosovës bazuar në Ligjin e Shëndetësisë, Nr.04/L-125 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015, drejtuar Kryetarëve të Kuvendeve Komunale, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VIII-të të radhës për vitin 2015, të mbajtur më 25.09.2015 mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Statuti i QKMF- "Nëna Terezë" në Klinë

I

Miratohet Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Nëna Terezë" në Klinë - Akt Unik, ky për të gjitha institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor të Kosovës, në veçanti me specifikat që i ka QKMF-ja në Komunën e Klinës.

II

Statuti si në pikën 1 të këtij Vendimi miratohet duke pasur për bazë specifikat e QKMF-së në Klinë siç janë:

Në nenin 2 të Statutit paragrafi 2 shtohet dhe qartësohet se Themeluesi i QKMF në Komunën e Klinës është Kuvendi Komunal në Klinë, pra në zbrazëtirën e këtij paragrafi shtohet selia e Kuvendit Komunal-Klinë.

Në kuadër të paragrafit 3 të nenit 2 po ashtu në zbrazëtirën shtohet fjala: **Klinë**. Po ashtu në kuadër të këtij paragrafi precizohet data e fillimit të punës të QKMF që është: **01.01.1948**.

Në nenin 3 paragrafi 1 në zbrazëtirën e lenë shtohet fjala e cila përcakton emërtimin e institucionit shëndetësor në Klinë e që është: **Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Nëna Terezë" me seli në Klinë**.

Në paragrafin 2 të nenit 3 të Statutit përcaktohet shenja njohëse e QKMF në Klinë e që është: **E formës së Katërkëndëshit kënddrejtë në anën e majtë të secilës është portreti i humanistes Nënë Tereza, në mes është i shkruar teksti, që përcakton statusin e njësisë organizative shkurtesën e saj dhe selinë, ndërsa në anën e djathtë është simboli i shëndetësisë**.

Nenit 3 i shtohet paragrafi 5 më tekstin siç vijon:

Dita e festës së QKMF-së është data e lindjes së Nënë Terezës, data 26 gusht 1910. Kjo datë festohet për çdo vit dhe njëkohësisht është ditë pune.

Në nenin 4 të Statutit përcaktohet selia e QKMF: **Në Klinë, që gjendet në rrugën “Muhamet Haxha” p.n. në Klinë.**

Në nenin 5 paragrafi 2 pika 2.2 shtohet fjala: **Klinë**, po ashtu në pikën 2.3 në zbrazetirën përkatëse shtohet fjala: **“Nëna Terezë” në Klinë.**

Në nenin 6 paragrafi 2 në vendin e zbrazet shtohet fjala: **Klinë.**

Në paragrafin 5 të nenit 6 të korrigjohet fjala Prishtinë të zëvendësohet me fjalën: **Klinë.**

Në nenin 8 paragrafi 1 në zbrazetirën e lënë shtohet fjala: **Klinë.**

Në nenin 8 paragrafi 1 në zbrazetirën e lënë shtohet fjala: **Klinë.**

Në nenin 9 paragrafi 2 fjala Prishtinë zëvendësohet me fjalën: **Klinë.**

Në të njëjtin paragraf në pikën 2.1; 2.2; 2.3; dhe 2.4 hiqet fjala zyre dhe mbetet fjala: **Njësi.**

Në paragrafin 4,5 dhe 6 në zbrazetira të lëna shtohet fjala: **Klinë.**

Në nenin 10 paragrafi 1 shtohet fjala: **Klinë.**

Në nenin 15 paragrafi 2 shtohet fjala: **Klinë.**

Në nenin 29 paragrafi 2 në zbrazetirën e lënë shtohet: **Nr.01-110-2597/07 i dt.03.07.2007.**

Aneksi i 1(një) vulave mbetet i njëjtë dhe është pjesë përbërëse e këtij Statuti.

III

Statuti me plotësime dhe ndryshime si në pikën 1 të këtij Vendimi hyn në fuqi sipas procedurës së paraparë ligjore.

IV

Me këtë Vendim njoftohet: MAPL, MSH, QKMF “Nëna Terezë” në Klinë, Kryetari i Komunës, Zyra për Informim, një kopje për dosje dhe një për Arkivin e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. *07-5365* 2015
Klinë, më 25.09.2015



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi